LIGJ
Nr. 71/2026

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR HEKURUDHAT SHQIPTARE – REHABILITIMI I HEKURUDHËS TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMI I LIDHJES HEKURUDHORE ME AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS: ZGJERIMI I PROJEKTIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për hekurudhat shqiptare – rehabilitimi i hekurudhës Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës: Zgjerimi i projektit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 439, datë 29.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

(Numri i veprimit 48466)
(ID-ja e objektit 92498)

MARRËVESHJE HUAJE

(Hekurudhat shqiptare – rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës
dhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës:
Zgjerimi i projektit)

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Datë 22 prill 2026

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I – TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET
Seksioni 1.01. Përfshirja e termave dhe kushteve standarde
Seksioni 1.02. Përkufizimet
Seksioni 1.03. Interpretimi
NENI II – KUSHTET KRYESORE TË HUAS

Seksioni 2.01. Shuma dhe valuta
Seksioni 2.02. Kushte të tjera financiare të Huas
Seksioni 2.03. Tërheqjet
Seksioni 2.04. Autorizimet
NENI III – ZBATIMI I ZGJERIMIT TË PROJEKTIT
Seksioni 3.01. Detyrime të tjera pozitive të projektit
NENI IV – PEZULLIMI; PËRSHPEJTIMI; ANULIMI
Seksioni 4.01. Pezullimi
Seksioni 4.02. Përshpejtimi i afatit të maturimit
NENI V – HYRJA NË FUQI
Seksioni 5.01. Kushtet paraprake për hyrjen në fuqi
Seksioni 5.02. Kushtet paraprake për tërheqjen e parë
Seksioni 5.03. Opinione ligjore
Seksioni 5.04. Zgjidhja e marrëveshjes për moshyrje në fuqi
NENI VI – DISPOZITA TË NDRYSHME
Seksioni 6.01. Njoftimet
SKEDULI 1 – PËRSHKRIMI I ZGJERIMIT TË PROJEKTIT
SKEDULI 2 – KATEGORITË DHE TËRHEQJET

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës 22 prill 2026, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

HYRJE

duke pasur parasysh se Banka është themeluar për të ofruar financim për projekte specifike, me qëllim nxitjen e kalimit drejt ekonomive të hapura të orientuara nga tregu dhe nxitjen e nismës private dhe sipërmarrëse në disa vende që janë të përkushtuara dhe zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

duke pasur parasysh se Huamarrësi dhe Banka kanë lidhur një marrëveshje huaje në datën 29 dhjetor 2016, e ndryshuar më 3 tetor 2024 (së bashku "Marrëveshja fillestare e Huas"), sipas së cilës Banka ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën totale prej 77,570,000 euro, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të referuara në të dhe në marrëveshjen e projektit, të datës fillestare 17 maj 2017, e ndryshuar më 3 tetor 2024, ndërmjet Entitetit të Projektit dhe Bankës (marrëveshja fillestare e projektit);

d*uke pasur parasysh se* Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në skedulin 1 të Marrëveshjes fillestare të Huas (Projekti), i cili është konceptuar për të ndihmuar në rehabilitimin e linjës hekurudhore ekzistuese ndërmjet qyteteve të Tiranës dhe Durrësit, dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore lidhëse me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës;

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka vendosur të zgjerojë Projektin përmes elektrifikimit të disa linjave hekurudhore, siç përshkruhet në skedulin 1 (përshkrimi i Zgjerimit të Projektit) (Zgjerimi i Projektit);

duke pasur parasysh se Projekti, duke përfshirë Zgjerimin e Projektit, do të realizohet nga Hekurudha Shqiptare sh.a. (Entiteti i Projektit) me mbështetje financiare nga Huamarrësi;

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e Zgjerimit të Projektit;

duke pasur parasysh se Banka është në procesin e sigurimit të fondeve të bashkëpunimit teknik deri në shumën 1,161,508 euro në formë granti për të ndihmuar Huamarrësin në zbatimin e Zgjerimit të Projektit, në përputhje me termat dhe kushtet që do të përcaktohen në një marrëveshje (marrëveshja e grantit për Zgjerimin) ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit;

duke pasur parasysh se Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) ka ofruar fonde granti në shumën 619,000 euro për përgatitjen e analizës së kostos dhe përfitimit (AKP), projektit paraprak, vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) dhe dokumenteve të tenderit për Zgjerimin e Projektit;

duke pasur parasysh se WBIF-ja pritet të ofrojë një grant deri në shumën 12,776,585 euro për të bashkëfinancuar deri në 50 për qind të kostos kapitale të Zgjerimit të Projektit, si dhe mbikëqyrjen e punimeve dhe mbështetjen për zbatimin e projektit, me kusht që disponueshmëria e fondeve të konfirmohet në dhjetor 2026; dhe

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord, *ndër të tjera*, mbi bazën e sa më sipër, t'i japë Huamarrësit një hua në shumën prej 11,620,000 euro për qëllimet e Zgjerimit të Projektit, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjen e projektit që mban datën e kësaj marrëveshjeje, ndërmjet Entitetit të Projektit dhe Bankës (Marrëveshja e Projektit).

si rrjedhojë, palët bien dakord, si më poshtë:

Neni I
Termat dhe kushtet standarde; përkufizimet

Seksioni 1.01. Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës, të datës 1 maj 2025, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu, megjithatë, në bazë të ndryshimeve të mëposhtme (dispozitat e tilla, siç janë ndryshuar, referohen më poshtë "Termat dhe kushtet standarde"):

a) Çdo referencë ndaj "Projektit" në termat dhe kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje, do të lexohet se përfshin Projektin, të zgjeruar nga Zgjerimi i Projektit.

Seksioni 1.02. Përkufizimet

Kurdo që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë hyrjen dhe skedulet), përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe ose kur konteksti kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në hyrje kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë aty, termat e përcaktuara në termat dhe kushtet e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"**Plan i veprimit mjedisor dhe social**" nënkupton planin e masave për zbutjen dhe përmirësimin mjedisor e social, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Projektit.

"**Plan i blerjes së tokës dhe i rikthimit të mjeteve të jetesës**" nënkupton planin e blerjes së tokës dhe rikthimit të mjeteve të jetesës, në lidhje me Zgjerimin e Projektit, të dorëzuar nga Huamarrësi (nëpërmjet Entitetit të Projektit) dhe të miratuar nga Banka, në përputhje me seksionin 5.01(i) të kësaj Marrëveshjeje.

"**NJZP**" **(Njësia e Zbatimit të Projektit)** nënkupton njësinë e zbatimit të projektit të referuar në seksionin 2.03 të Marrëveshjes së Projektit.

"**Marrëveshje dytësore huaje**" nënkupton Marrëveshjen e Huas që do të lidhet ndërmjet Entitetit të Projektit dhe Huamarrësit, në përputhje me seksionin 3.01(a), ku kjo marrëveshje huaje mund të ndryshohet herë pas here.

"**Plan i angazhimit të palëve të interesuara**" nënkupton planin e angazhimit të palëve të interesuara, të dorëzuar nga Huamarrësi (nëpërmjet Entitetit të Projektit) dhe të miratuar nga Banka në përputhje me seksionin 5.01(j) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni, seksioni ose skeduli të caktuar do të interpretohet, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, si një referencë ndaj atij neni, seksioni ose skeduli të caktuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Kushtet kryesore të Huas

Seksioni 2.01. Shuma dhe valuta

Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, një shumë deri në 11,620,000 euro.

Seksioni 2.02. Kushtet e tjera financiare të Huas

a) Shuma minimale e tërheqjes do të jetë 250,000 euro.

b) Shuma minimale e parapagimit do të jetë 5,000,000 euro.

c) Shuma minimale e anulimit do të jetë 1,000,000 euro.

d) Datat e pagesës së interesit do të jenë 30 maj dhe 30 nëntor të çdo viti.

e) 1. Huamarrësi do ta shlyejë Huan në 24 këste gjashtëmujore të barabarta (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) në secilën datë të pagesës së interesit, me datën e parë të shlyerjes së Huas që bie në datën e pagesës së interesit menjëherë pas përvjetorit të tretë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pavarësisht sa më sipër, në rast se: i. Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e Huas përpara datës së parë të shlyerjes së Huas të përcaktuar në këtë seksion 2.02(e); dhe ii. Banka e zgjat datën e fundit të disponueshmërisë të përcaktuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë që bie pas asaj date të parë të shlyerjes së Huas, atëherë shuma e çdo tërheqjeje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së Huas do të shpërndahet për shlyerje në shuma të barabarta në disa data shlyerjeje të Huas që bien pas datës së një tërheqjeje të tillë (me Bankën që rregullon shumat e shpërndara, sipas nevojës, për të arritur numra të plotë në çdo rast). Banka, herë pas here, do ta njoftojë Huamarrësin për këto alokime;

f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë data që bie katër vjet nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje ose një datë më e vonshme që Banka, me kërkesë të Huamarrësit, mund ta përcaktojë sipas diskrecionit të saj dhe të njoftojë Huamarrësin;

g) Norma e komisionit të angazhimit do të jetë 0.5% në vit;

h) Huaja i nënshtrohet një norme interesi të ndryshueshme. Pavarësisht sa më sipër, Huamarrësi mund të zgjedhë, si alternativë ndaj pagesës së interesit me normë interesi të ndryshueshme për të gjithë ose për ndonjë pjesë të Huas së papaguar, të paguajë interes me normë fikse interesi për atë pjesë të Huas, në përputhje me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e skedulit 2 për të financuar: 1. shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka pranon, që do të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe punimeve të nevojshme për Zgjerimin e Projektit; dhe 2. komisionin fillestar.

Seksioni 2.04. Autorizimet

a) Administratori i Entitetit të Projektit caktohet si përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit për qëllimin e ndërmarrjes së çdo veprimi të kërkuar ose të lejuar të ndërmerret sipas dispozitave të seksionit 2.03 dhe sipas dispozitave të seksioneve 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde;

b) Huamarrësi është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim i cili, përpara nënshkrimit, duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë së financimit, nuk do të kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

Neni III
Zbatimi i zgjerimit të projektit

Neni 3.01. Detyrime të tjera pozitive të Projektit

Përveç angazhimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenet IV dhe V, të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, duhet:

a) t'i vendosë në dispozicion Entitetit të Projektit, në bazë të marrëveshjes dytësore të Huas, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të ardhurat e Huas me terma dhe kushte të pranueshme për Bankën;

b) të ushtrojë të drejtat e tij sipas marrëveshjes dytësore të Huas në një mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Bankës, të përmbushë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe të realizojë qëllimet për të cilat është dhënë Huaja;

c) përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, të mos caktojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga ndonjë dispozitë e marrëveshjes dytësore të Huas;

d) të marrë masa që Entiteti i Projektit të përmbushë të gjitha detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Projektit, duke përfshirë, pa kufizim, detyrimet e tij që lidhen me:

1. krijimin dhe funksionimin e një njësie zbatimi të projektit, siç parashikohet në seksionin 2.03 të Marrëveshjes së Projektit;

2. prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve, siç parashikohet në seksionin 2.04 të Marrëveshjes së Projektit;

3. çështjet mjedisore dhe sociale, siç parashikohet në seksionin 2.05 të Marrëveshjes së Projektit;

4. punësimin dhe përdorimin e konsulentëve për të ndihmuar në zbatimin, siç parashikohet në seksionin 2.06 të Marrëveshjes së Projektit;

5. mirëmbajtjen e procedurave, regjistrave dhe llogarive, përgatitjen, auditimin dhe dorëzimin në Bankë të pasqyrave financiare dhe pajisjen e Bankës me çdo informacion tjetër përkatës që lidhet me Zgjerimin e Projektit ose veprimet e Entitetit të Projektit, siç parashikohet në seksionin 3.01 të Marrëveshjes së Projektit;

6. përputhjen me të gjitha angazhimet, lidhur me aspektet financiare dhe operacionale të Zgjerimit të Projektit dhe Entitetit të Projektit, siç parashikohet në seksionet 3.02, 3.03 dhe 3.04 të Marrëveshjes së Projektit;

7. garantimin që Entiteti i Projektit të ketë fonde të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e mirëmbajtjes të identifikuara në planin e menaxhimit të aseteve;

8. pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve, tarifave ose shumave të tjera të pagueshme, në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e Marrëveshjes së Projektit dhe çdo dokumenti tjetër të lidhur me këtë Marrëveshje;

9. delegimin tek NJZP-ja (Njësia a Zbatimit të Projektit) nëpërmjet Entitetit të Projektit të menaxhimit të përditshëm të Zgjerimit të Projektit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në menaxhimin e konsoliduar financiar dhe të prokurimit;

10. vënien në zbatim, sa herë që është e nevojshme, të rregullimeve në nivelin dhe strukturën e tarifave të Entitetit të Projektit, në mënyrë që Entiteti i Projektit të mund të përmbushë detyrimet e tij dhe të lejojë arritjen nga Entiteti i Projektit të rikuperimit të plotë të kostos për shërbimet e tij; dhe

11. dhënien ose marrjen e masave për dhënien, kur kërkohet, të të gjitha licencave, miratimeve ose lejeve qeveritare të kërkuara nga Entiteti i Projektit për financimin dhe kryerjen e Zgjerimit të Projektit dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij, duke përfshirë të gjitha miratimet dhe licencat e nevojshme për të siguruar që Entitetit të Projektit t'i jepen të drejtat e kalimit dhe të drejtat e tjera të përdorimit të tokës të nevojshme për kryerjen e Zgjerimit të Projektit;

e) Të mbështesë Entitetin e Projektit, të sigurojë ose të marrë masa që të sigurohen fonde për Entitetin e Projektit sa herë që i nevojiten për të arritur përfundimin e Projektit;

f) Të sigurojë prova, nëpërmjet Entitetit të Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, se projekti përfundimtar është përfunduar dhe miratuar siç duhet për të përfshirë masat e qëndrueshmërisë klimatike që rezultojnë nga Raporti i Përafrimit me Marrëveshjen e Parisit (i përgatitur gjatë procesit të kujdesit të duhur).

Neni IV
Pezullimi; përshpejtimi; anulimi

Seksioni 4.01. Pezullimi

Për qëllimet e seksionit 7.01(a)(xvii) të termave dhe kushteve standarde, specifikohen sa vijon:

a) Kuadri ligjor dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin në të cilin vepron Entiteti i Projektit duhet të jetë ndryshuar, pezulluar, revokuar, shfuqizuar, ose hequr dorë prej tij në një mënyrë tjetër nga ajo e miratuar me shkrim nga Banka;

b) Statutet duhet të jenë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, revokuar ose hequr dorë prej tyre;

c) Kontrolli mbi Entitetin e Projektit është transferuar tek një palë tjetër përveç Huamarrësit; ose

d) Entiteti i Projektit nuk ka mundur të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas marrëveshjes dytësore të Huas.

Seksioni 4.02. Përshpejtimi i afatit të maturimit

Për qëllimet e nenit 7.06(f) të termave dhe kushteve standarde, specifikohet sa vijon: çdo rast i specifikuar në seksionin 4.01, që ka vazhduar për tridhjetë ditë pas njoftimit të Bankës drejtuar Huamarrësit mbi konstatimin se ka ndodhur një rast i tillë.

Neni V
Hyrja në fuqi

Seksioni 5.01. Kushtet paraprake për hyrjen në fuqi

Për qëllimet e seksionit 9.02(c) të termave dhe kushteve standarde, sa vijon përcaktohen si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Projektit:

a) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka ratifikuar këtë Marrëveshje dhe ratifikimi i saj është botuar në Fletoren Zyrtare; dhe

b) Marrëveshja e Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, është nënshkruar dhe dorëzuar, dhe nënshkrimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes së Projektit janë autorizuar sipas rregullave.

Seksioni 5.02. Kushtet paraprake për tërheqjen e parë

Detyrimi i Bankës për të kryer disbursimin e parë të Huas (përveç pagesës së Komisionit Fillestar) do t'i nënshtrohet përmbushjes paraprake, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën ose sipas gjykimit të vetëm të Bankës, heqjes dorë, qoftë tërësisht apo pjesërisht dhe qoftë në bazë të kushteve apo i pakushtëzuar, nga kushtet shtesë paraprake të mëposhtme:

a) Marrja nga Banka, të provave, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, mbi disponueshmërinë e financimit nga WBIF-i;

b) Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP), me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, të pranueshme për Bankën, është krijuar dhe është funksionale;

c) Emërimi nga Entiteti i Projektit, i konsulentëve të financuar nëpërmjet granteve të dhëna nga WBIF-i dhe Banka për të asistuar NJZP-në në përgatitjen, zbatimin, ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e Zgjerimit të Projektit;

d) Banka është pajisur me prova nga Entiteti i Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, mbi zbatimin e duhur të Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social;

e) Banka ka marrë nga Entiteti i Projektit Planin e Blerjes së Tokës dhe të Rikthimit të Mjeteve të Jetesës, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

f) Banka është pajisur me prova nga Entiteti i Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, mbi zbatimin e duhur të Planit të Angazhimit të Palëve të Interesuara, së bashku me një mekanizëm funksional dhe të pajisur me personel të ankesave nga palë të treta.

Seksioni 5.03. Opinionet ligjore

a) Për qëllimet e nenit 9.03(a) të termave dhe kushteve standarde, opinioni ose opinionet ligjore do të jepen në emër të Huamarrësit nga ministri i Drejtësisë dhe sa vijon, përcaktohen si çështje shtesë që duhet të përfshihen në opinionin ose opinionet që do t'i dorëzohen Bankës:

1. Marrëveshja dytësore e Huas është autorizuar sipas rregullave dhe është dorëzuar në emër të Huamarrësit, dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht të detyrueshëm të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj;

b) Për qëllimet e seksionit 9.03(c) të termave dhe kushteve standarde, opinioni ose opinionet ligjore do të jepen në emër të Entitetit të Projektit nga drejtuesi i departamentit ligjor të Entitetit të Projektit dhe sa vijon do të përcaktohen si çështje shtesë që duhet të përfshihen në opinionin ose opinionet që do t'i dorëzohen Bankës:

1. Marrëveshja dytësore e Huas është autorizuar sipas rregullave, është nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Entitetit të Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht të detyrueshëm të Entitetit të Projektit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj; dhe

2. Marrëveshja e Projektit është autorizuar sipas rregullave, është nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Entitetit të Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht të detyrueshëm të Entitetit të Projektit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 5.04. Përfundimi për shkak të moshyrjes në fuqi

Data, 180 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, specifikohet për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Neni VI

Dispozita të ndryshme

Seksioni 6.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Bulv. "Dëshmorët e Kombit", 3
Tiranë,
Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për BERZH-in:

European Bank for Reconstruction and Development
5 Bank Street
London E14 4BG
United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Në vëmendje të: Shërbimeve Bankare/veprimi nr. 48466/ID-ja e objektit 92498

Telefon: +44 20 7338 6000
Email: bankingservices@ebrd.com

b) Banka mund ta ftojë Huamarrësin që të regjistrohet për të përdorur ClientNet ose formë tjetër komunikimi elektronik dhe, nëse Huamarrësi dhe Banka bien dakord të përdorin ClientNet ose një formë tjetër komunikimi elektronik, çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër nga Huamarrësi për Bankën ose nga Banka për Huamarrësin (përveç ndonjë njoftimi, aplikimi ose komunikimi tjetër që kërkohet nga kjo Marrëveshje ose ndonjë marrëveshje tjetër financimi, të jetë në origjinal, i certifikuar ose në kopje të printuar), në bazë të termave dhe kushteve të ClientNet ose një forme tjetër komunikimi elektronik, mund të jepet ose bëhet duke postuar një njoftim, aplikim ose komunikim tjetër në ClientNet ose të dërgohet në përputhje me kushtet e dakordësuara në lidhje me një formë tjetër komunikimi elektronik.

c) Çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër i dorëzuar dorazi, me postë ajrore ose faks ose nëpërmjet ClientNet ose një forme tjetër të rënë dakord të komunikimit elektronik do të jetë i vlefshëm vetëm kur të merret (ose të vihet në dispozicion) në formë të lexueshme, me kusht që çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër që merret (ose vihet në dispozicion) pas orës 17:00 në vendin ku pala së cilës i dërgohet njoftimi, aplikimi ose komunikimi përkatës ka adresën e saj për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet se hyn në fuqi vetëm ditën pasuese.

d) Më poshtë jepen emrat, titujt dhe adresat e email-it të personave të caktuar si kontaktet fillestare të Huamarrësit për qëllimet e çdo ftese që Banka mund t'i dërgojë Huamarrësit, në lidhje me ClientNet: Ju lutem të kini parasysh se adresat e email-it në grup nuk mund të regjistrohen për të përdorur ClientNet. Si rrjedhojë, adresat e email-it të listuara më poshtë, duhet të jenë vetëm për persona individë.

Emri	Titulli	*Adresa e email*-it	Gjuha – anglisht, rusisht, frëngjisht
Irena Gjika	Drejtuese e Njësisë së Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë	irena.gjika@financa.gov.al	Anglisht
Sonila Shamata	Specialiste, Njësia e Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë	sonila.shamata@financa.gov.al	Anglisht

në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në tri kopje (një kopje për Huamarrësin dhe dy kopje për Bankën) dhe të dorëzohet në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e përcaktuar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga: /nënshkrimi/
Emri: Petrit Malaj
Titulli: Ministri i Financave

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga: /nënshkrimi/
Emri: Ekaterina Solovova
Titulli: Drejtuese për Shqipërinë

SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I ZGJERIMIT TË PROJEKTIT

1. Qëllimi i Zgjerimit të Projektit është të asistojë Huamarrësin, në:

i. elektrifikimin e linjës ekzistuese hekurudhore midis qyteteve të Tiranës dhe Durrësit (me gjatësi të përafërt 34.17 km); dhe

ii. elektrifikimin e lidhjes së re hekurudhore të ndërtuar që lidh linjat ekzistuese me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (me gjatësi të përafërt 5 km).

2. Zgjerimi i Projektit përbëhet nga pjesët e mëposhtme, të cilat mund të ndryshohen, siç Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: Punime ndërtimi që lidhen me:

a) elektrifikimin e linjës ekzistuese hekurudhore ndërmjet qyteteve të Tiranës dhe Durrësit (me gjatësi të përafërt 34.17 km); dhe

b) elektrifikimin e lidhjes së re hekurudhore të ndërtuar që lidh linjat ekzistuese me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (me gjatësi të përafërt 5 km).

Pjesa B: Shërbime konsulence për mbështetjen e zbatimit të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve për pjesën A.

3. Zgjerimi i Projektit pritet të përfundojë deri më 1 prill 2027.

SKEDULI 2
KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur këtij skeduli përcakton kategoritë, shumën e Huas të alokuar për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në secilën kategori.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 më sipër, nuk do të bëhet asnjë tërheqje, në lidhje me shpenzimet e kryera para datës së Marrëveshjes së Huas.

Bashkëlidhje e shtojcës 2

Kategoria	Shuma e Huas e alokuar në valutën e Huas	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Punime elektrifikimi të financuara nga Huaja	11,500,000 EURO	100% (duke përjashtuar çdo taksë)
2. Komisioni fillestar	120,000 EURO	100%
Totali	**11,620,000 EURO**	

Parashikimet e Kostove të Projektit dhe Plani i Financimit

Kostot e Projektit dhe plani i financimit (milionë Euro)	Huaja e BERZH-it	Granti i BERZH-it	Granti i BE-së/WBIF-së	Qeveria e Shqipërisë	TOTALI
Punime elektrifikimi (përfshirë fondin e paparashikuar, duke përjashtuar TVSH-në)	11.62	0	11.62	0	**23.24**
Përgatitja e projektit*	0	0	0.62	0	**0.62**
Mbështetje për zbatimin dhe mbikëqyrjen	0	0	1.16	0	**1.16**
Blerja e tokës	0	0	0	0.1	**0.1**
TOTALI					**25.12**

* Ky komponent i projektit është realizuar.

LOAN AGREEMENT

(Albanian Railways - Rehabilitation of the Tirana-Durres railway and construction of rail link to Tirana International Airport: Project Extension)

between

THE REPUBLIC OF ALBANIA

and

EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT

Dated 22 April 2026

TABLE OF CONTENTS

ARTICLE I - STANDARD TERMS AND CONDITIONS; DEFINITIONS 2
Section 1.01. Incorporation of Standard Terms and Conditions 2
Section 1.02. Definitions 2
Section 1.03. Interpretation 3

ARTICLE II - PRINCIPAL TERMS OF THE LOAN 3
Section 2.01. Amount and Currency 3
Section 2.02. Other Financial Terms of the Loan 3
Section 2.03. Drawdowns 4
Section 2.04 Authorisations 4

ARTICLE III - EXECUTION OF THE PROJECT EXTENSION 4
Section 3.01. Other Affirmative Project Covenants 4

ARTICLE IV - SUSPENSION; ACCELERATION; CANCELLATION 6
Section 4.01. Suspension 6
Section 4.02. Acceleration of Maturity 6

ARTICLE V - EFFECTIVENESS 6
Section 5.01. Conditions Precedent to Effectiveness 6
Section 5.02. Conditions Precedent to First Drawdown 7
Section 5.03. Legal Opinions 7
Section 5.04. Termination for Failure to Become Effective 8

ARTICLE VI - MISCELLANEOUS 8
Section 6.01. Notices 8

SCHEDULE 1 - DESCRIPTION OF THE PROJECT EXTENSION 11

SCHEDULE 2 - CATEGORIES AND DRAWDOWNS 12

LOAN AGREEMENT

AGREEMENT dated 22 April 2026 between the **REPUBLIC OF ALBANIA** represented by the Ministry of Finance (the "**Borrower**") and **EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT** (the "**Bank**").

PREAMBLE

WHEREAS, the Bank has been established to provide financing for specific projects to foster the transition towards open market-oriented economies and to promote private and entrepreneurial initiative in certain countries committed to and applying the principles of multiparty democracy, pluralism and market economics;

WHEREAS, the Borrower and the Bank entered into a loan agreement dated 29 December 2016 as amended on 3 October 2024 (together the "Original Loan Agreement") pursuant to which the Bank agreed to make a loan to the borrower in the aggregate amount of EUR 77,570,000, subject to the terms and conditions set forth or referred to therein and in the project agreement originally dated 17 May 2017, as amended on 3 October 2024, between the Project Entity and the Bank (the "Original Project Agreement");

WHEREAS, the Borrower intends to implement the project as described in Schedule 1 of the Original Loan Agreement (the "Project"), which is designed to assist in the rehabilitation of the existing railway line between the cities of Tirana and Durres and the construction of a new railway line connection to Tirana International Airport;

WHEREAS, the Borrower has decided to extend the Project by the electrification of certain railway lines, as described in Schedule 1 (*Description of the Project Extension*) (the "Project Extension");

WHEREAS, the Project, including the Project Extension, will be carried out by Hekurudha Shqiptare sh.a (the "Project Entity") with financial assistance from the Borrower;

WHEREAS, the Borrower has requested assistance from the Bank in financing the Project Extension;

WHEREAS, the Bank is in the process of arranging technical cooperation funds of up to EUR 1,161,508 on a grant basis to assist the Borrower in implementing the Project Extension, subject to the terms and conditions to be set forth in an agreement (the "Extension Grant Agreement") between the Bank and the Borrower;

WHEREAS, the Western Balkans Investment Framework ("WBIF") has provided grant funds in the amount of EUR 619,000 for the preparation of the cost benefit analysis ("CBA"), preliminary design, environmental and social impact assessment ("ESIA") and tender documents for the Project Extension;

WHEREAS, the WBIF is expected to provide a grant of up to EUR 12,776,585 to co-finance up to 50 per cent of the Project Extension's capital cost and works supervision

and project implementation support, subject to the availability of funds being confirmed in December 2026; and

WHEREAS, the Bank has agreed on the basis of, *inter alia*, the foregoing to make a loan to the Borrower in the amount of EUR 11,620,000 for the purposes of the Project Extension, subject to the terms and conditions set forth or referred to in this Agreement and in the project agreement dated the date hereof between the Project Entity and the Bank (the "Project Agreement").

NOW, THEREFORE, the parties hereby agree as follows:

ARTICLE I - STANDARD TERMS AND CONDITIONS; DEFINITIONS

Section 1.01. Incorporation of Standard Terms and Conditions

All of the provisions of the Bank's Standard Terms and Conditions dated 1 May 2025 are hereby incorporated into and made applicable to this Agreement with the same force and effect as if they were fully set forth herein, subject, however, to the following modifications (such provisions as so modified are hereinafter called the "Standard Terms and Conditions"):

(a) Any reference to "the Project" in the Standard Terms and Conditions or this Agreement, shall be read to include the Project as extended by the Project Extension.

Section 1.02. Definitions

Wherever used in this Agreement (including the Preamble and Schedules), unless stated otherwise or the context otherwise requires, the terms defined in the Preamble have the respective meanings given to them therein, the terms defined in the Standard Terms and Conditions have the respective meanings given to them therein and the following terms have the following meanings:

"Environmental and Social Action Plan"	means the plan of environmental and social mitigation and improvement measures as defined in the Project Agreement.
"Land Acquisition and Livelihood Restoration Plan"	means the land acquisition and livelihood restoration plan in connection with the Project Extension, delivered by the Borrower (through the Project Entity) and approved by the Bank in accordance with Section 5.01(i) of this Agreement.

"PIU"	means the project implementation unit referred to in Section 2.03 of the Project Agreement.
"Subsidiary Loan Agreement"	means the loan agreement to be entered into between the Project Entity and the Borrower pursuant to Section 3.01(a), as such loan agreement may be amended from time to time.
"Stakeholder Engagement Plan"	means the stakeholder engagement plan delivered by the Borrower (through the Project Entity) and approved by the Bank in accordance with Section 5.01(j) of this Agreement.

Section 1.03. Interpretation

In this Agreement, a reference to a specified Article, Section or Schedule shall, except where stated otherwise in this Agreement, be construed as a reference to that specified Article or Section of, or Schedule to, this Agreement.

ARTICLE II - PRINCIPAL TERMS OF THE LOAN

Section 2.01. Amount and Currency

The Bank agrees to lend to the Borrower, on the terms and conditions set forth or referred to in this Agreement, the amount of up to EUR 11,620,000

Section 2.02. Other Financial Terms of the Loan

(a) The Minimum Drawdown Amount shall be EUR 250,000.

(b) The Minimum Prepayment Amount shall be EUR 5,000,000.

(c) The Minimum Cancellation Amount shall be EUR 1,000,000.

(d) The Interest Payment Dates shall be 30 May and 30 November of each year.

(e) (1) The Borrower shall repay the Loan in 24 equal (or as nearly equal as possible) semi-annual instalments on each Interest Payment Date, with the first Loan Repayment Date falling on the next Interest Payment Date immediately following the third anniversary of this Agreement.

(2) Notwithstanding the foregoing, in the event that (i) the Borrower does not draw down the entire Loan amount prior to the first Loan Repayment Date specified in this Section 2.02 (e), and (ii) the Bank extends the Last Availability Date specified in Section 2.02 (f) below to a date which falls after such first Loan Repayment Date, then the amount of each drawdown made on or after the first Loan Repayment Date shall be allocated for repayment in equal amounts to the several

Loan Repayment Dates which fall after the date of such drawdown (with the Bank adjusting the amounts so allocated as necessary so as to achieve whole numbers in each case). The Bank shall, from time to time, notify the Borrower of such allocations.

(f) The Last Availability Date shall be the date being four years from the signing of this Agreement, or such later date that the Bank, upon request of the Borrower, may in its discretion establish and notify to the Borrower.

(g) The rate of the Commitment Charge shall be 0.5% per annum.

(h) The Loan is subject to a Variable Interest Rate. Notwithstanding the foregoing, the Borrower may, as an alternative to paying interest at a Variable Interest Rate on all or any portion of the Loan then outstanding, elect to pay interest at a Fixed Interest Rate on such portion of the Loan in accordance with Section 3.04(c) of the Standard Terms and Conditions.

Section 2.03. Drawdowns

The Available Amount may be drawn down from time to time in accordance with the provisions of Schedule 2 to finance (1) expenditures made (or, if the Bank so agrees, to be made) in respect of the reasonable cost of goods and works required for the Project Extension and (2) the Front-end Commission.

Section 2.04 Authorisations

(a) The Administrator of the Project Entity is designated as the Borrower's Authorised Representative for the purpose of taking any action required or permitted to be taken under the provisions of Section 2.03 and under the provisions of Sections 3.01 and 3.02 of the Standard Terms and Conditions.

(b) The Borrower is authorised to sign any amendment which, prior to signing, must be approved by the Council of Ministers. Amendments to this Agreement affecting only the availability period of the financing shall not require prior approval by the Council of Ministers.

ARTICLE III - EXECUTION OF THE PROJECT EXTENSION

Section 3.01. Other Affirmative Project Covenants

In addition to the general undertakings set forth in Articles IV and V of the Standard Terms and Conditions, the Borrower shall, unless the Bank otherwise agrees:

(a) Make available to the Project Entity, pursuant to the Subsidiary Loan Agreement in form and substance satisfactory to the Bank, the proceeds of the Loan on terms and conditions acceptable to the Bank;

(b) Exercise its rights under the Subsidiary Loan Agreement in such manner as to protect the interests of the Borrower and the Bank, to comply with the provisions of this Agreement and to accomplish the purposes for which the Loan is made;

(c) Not, except as the Bank otherwise agrees, assign, amend, abrogate or waive any provision of the Subsidiary Loan Agreement;

(d) Cause the Project Entity to perform all of its obligations under the Project Agreement, including without limitation its obligations relating to:

(1) establishment and operation of a project implementation unit as provided for in Section 2.03 of the Project Agreement;

(2) procurement of goods, works and services as provided for in Section 2.04 of the Project Agreement;

(3) environmental and social matters as provided for in Section 2.05 of the Project Agreement;

(4) employment and use of consultants to assist in implementation, as provided for in Section 2.06 of the Project Agreement;

(5) maintenance of procedures, records and accounts, preparation, auditing and submission to the Bank of financial statements and furnishing to the Bank any other relevant information relating to the Project Extension or the Project Entity's operations as provided for in Section 3.01 of the Project Agreement;

(6) compliance with all covenants regarding financial and operational aspects of the Project Extension and the Project Entity as provided for in Sections 3.02, 3.03 and 3.04 of the Project Agreement;

(7) ensuring that the Project Entity has sufficient funds to cover the maintenance requirements identified in the asset management plan;

(8) payment of all taxes, duties, fees or other charges payable in connection with the execution, issue, delivery, registration or notarisation of the Project Agreement and any other document related to this Agreement;

(9) delegation to the PIU through the Project Entity of the day-to-day management of the Project Extension including, but not limited to, the consolidated financial and procurement management;

(10) putting into effect, as frequently as needed, adjustments to the level and structure of the Project Entity's tariffs so as to ensure that the Project Entity is able to fulfil its obligations and to allow the achievement by the Project Entity of the full cost recovery for its services; and

(11) providing or causing to be provided, when requested, all governmental licences, approvals or consents required by the Project Entity for the financing and carrying out of the Project Extension and carrying on its business, including all approvals and licences necessary to ensure that the Project Entity is granted rights

of way and other land use rights necessary for carrying out the Project Extension; and

(e) Support the Project Entity, provide, or cause to be provided, funds to the Project Entity as and when needed by it to achieve Project completion.

(f) Provide through the Project Entity evidence, in form and substance satisfactory to the Bank, that the final design has been completed and duly approved to incorporate climate resilience measures resulting from the Paris Agreement Alignment Report (as prepared during due diligence).

ARTICLE IV - SUSPENSION; ACCELERATION; CANCELLATION

Section 4.01. Suspension

The following are specified for purposes of Section 7.01(a)(xvii) of the Standard Terms and Conditions:

(a) The legislative and regulatory framework applicable to the sector in which the Project Entity operates shall have been amended, suspended, abrogated, repealed or waived in a manner other than as approved by the Bank in writing;

(b) The Statutes shall have been amended, suspended, abrogated, repealed or waived;

(c) Control of the Project Entity shall have been transferred to a party other than the Borrower; or

(d) The Project Entity shall have failed to perform any of its obligations under the Subsidiary Loan Agreement.

Section 4.02. Acceleration of Maturity

The following is specified for purposes of Section 7.06(f) of the Standard Terms and Conditions: any event specified in Section 4.01 which shall have continued for thirty days after the notice of the determination that such an event had occurred has been given by the Bank to the Borrower.

ARTICLE V - EFFECTIVENESS

Section 5.01. Conditions Precedent to Effectiveness

The following are specified for purposes of Section 9.02(c) of the Standard Terms and Conditions as additional conditions to the effectiveness of this Agreement and the Project Agreement:

(a) The Parliament of the Republic of Albania has ratified this Agreement and such ratification has been published in the official gazette; and

(b) The Project Agreement, in form and substance satisfactory to the Bank, has been executed and delivered, and the execution and delivery of the Project Agreement has been duly authorised.

Section 5.02. Conditions Precedent to First Drawdown

The obligation of the Bank to make the first disbursement of the Loan (other than in respect of payment of the Front-End Commission) shall be subject to the prior fulfilment, in form and substance satisfactory to the Bank, or at the sole discretion of the Bank, the waiver, whether in whole or part and whether subject to conditions or unconditional, of the following additional conditions precedent:

(a) Receipt by the Bank of evidence, in form and substance satisfactory to it, of the availability of funding from the WBIF;

(b) The PIU, with adequate resources and suitably qualified personnel, acceptable to the Bank, has been established and is operational;

(c) Appointment by the Project Entity of consultants funded through grants provided by the WBIF and the Bank to assist the PIU with the preparation, implementation, execution and supervision of the Project Extension;

(d) The Bank has been furnished with evidence from the Project Entity, in form and substance satisfactory to the Bank, of due implementation of the Environmental and Social Action Plan;

(e) The Bank has received from the Project Entity the Land Acquisition and Livelihood Restoration Plan in form and substance satisfactory to the Bank;

(f) The Bank has been furnished with evidence from the Project Entity, in form and substance satisfactory to the Bank, of due implementation of the Stakeholder Engagement Plan along with staffed and functional third-party grievance mechanism.

Section 5.03. Legal Opinions

(a) For purposes of Section 9.03(a) of the Standard Terms and Conditions, the opinion or opinions of counsel shall be given on behalf of the Borrower by the Minister of Justice and the following are specified as additional matters to be included in the opinion or opinions to be furnished to the Bank:

(1) the Subsidiary Loan Agreement has been duly authorised, and delivered on behalf of, the Borrower and constitutes a valid and legally binding obligation of the Borrower, enforceable in accordance with its terms.

(b) For purposes of Section 9.03(c) of the Standard Terms and Conditions, the opinion or opinions of counsel shall be given on behalf of the Project Entity by the head of the

legal department of the Project Entity and the following are specified as additional matters to be included in the opinion or opinions to be furnished to the Bank:

(1) the Subsidiary Loan Agreement has been duly authorised, and executed and delivered on behalf of, the Project Entity and constitutes a valid and legally binding obligation of the Project Entity, enforceable in accordance with its terms; and

(2) the Project Agreement has been duly authorised, and executed and delivered on behalf of, the Project Entity and constitutes a valid and legally binding obligation of the Project Entity, enforceable in accordance with its terms.

Section 5.04. Termination for Failure to Become Effective

The date 180 days after the date of this Agreement is specified for purposes of Section 9.04 of the Standard Terms and Conditions.

ARTICLE VI - MISCELLANEOUS

Section 6.01. Notices

The following addresses are specified for purposes of Section 10.01 of the Standard Terms and Conditions:

For the Borrower:

Ministry of Finance of the Republic of Albania
Bul. Dëshmorët e Kombit 3
Tirana
Albania

Attention: The Minister of Finance
Email: sekretariamin@financa.gov.al

For EBRD:

European Bank for Reconstruction and Development
5 Bank Street
London E14 4BG
United Kingdom

Attention: Banking Services / Operation No. 48466 / Facility ID 92498

Telephone: +44 20 7338 6000
Email: bankingservices@ebrd.com

(b) The Bank may invite the Borrower to register to use ClientNet or another form of electronic communication and, if the Borrower and the Bank agree to use ClientNet or such other form of electronic communication, any notice, application or other

communication from the Borrower to the Bank or from the Bank to the Borrower (other than any notice, application or other communication that is required by this Agreement or any other Financing Agreement to be in an original, certified or hard copy), may, subject to the terms and conditions of ClientNet or such other form of electronic communication, be given or made by posting such notice, application or other communication on ClientNet or sent in accordance with the terms agreed concerning such other form of electronic communication.

(c) Any notice, application or other communication delivered by hand, airmail or facsimile transmission or via ClientNet or another agreed form of electronic communication will only be effective when actually received (or made available) in readable form, provided that any notice, application or other communication that is received (or made available) after 5:00 p.m. in the place in which the party to whom the relevant notice, application or communication is sent has its address for the purpose of this Agreement shall be deemed only to become effective on the following day.

(d) The following are the names, titles and email addresses of the persons designated as the initial contacts of the Borrower for purposes of any invitation the Bank may send to the Borrower regarding ClientNet:Please note that group email addresses cannot be registered to use ClientNet therefore the email addresses listed below should be for individual persons only.

Name	***Title***	***E-mail address***	***Language - English, Russian, French***
Irena Gjika	Head of Debt Recording and Servicing Unit, General Directorate of State Debt, Ministry of Finance of the Republic of Albania	irena.gjika@financa.gov.al	English
Sonila Shamata	Specialist, Debt Recording and Servicing Unit General Directorate of State Debt, Ministry of Finance of the Republic of Albania	sonila.shamata@financa.gov.al	English

IN WITNESS WHEREOF, the parties hereto, acting through their duly authorised representatives, have caused this Agreement to be signed in three copies (one copy for the Borrower and two copies for the Bank) and delivered at Tirana, Albania as of the day and year first above written.

THE REPUBLIC OF ALBANIA

By: _____

Name: Petrit Malaj
Title: Minister of Finance

EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT

By: _____

Name: Ekaterina Solovova
Title: Head of Albania

SCHEDULE 1 - DESCRIPTION OF THE PROJECT EXTENSION

1. The purpose of the Project Extension is to assist the Borrower in:

   (i) the electrification of the existing railway line between the cities of Tirana and Durres (with approximate length of 34.17 km); and
   (ii) the electrification of the newly constructed railway link connecting the existing lines to the Tirana International Airport (with approximate length of 5 km).

2. The Project Extension consists of the following Parts, subject to such modifications thereof as the Bank and the Borrower may agree upon from time to time:

   Part A: Construction works relating to:

   a. the electrification of the existing railway line between the cities of Tirana and Durres (with approximate length of 34.17 km); and
   b. the electrification of the newly constructed railway link connecting the existing lines to the Tirana International Airport (with approximate length of 5 km).

   Part B: Consultancy services for project implementation support and works supervision for Part A.

3. The Project Extension is expected to be completed by 1 April 2027.

SCHEDULE 2 - CATEGORIES AND DRAWDOWNS

1. The table attached to this Schedule sets forth the Categories, the amount of the Loan allocated to each Category and the percentage of expenditures to be financed in each Category.

2. Notwithstanding the provisions of paragraph 1 above, no Drawdown shall be made in respect of expenditures incurred prior to the date of the Loan Agreement.

Attachment to Schedule 2

Category	Amount of the Loan Allocated in the Loan Currency	Percentage of Expenditures to be Financed
(1) Electrification works funded by the Loan	EUR 11,500,000	100% excluding any Taxes
(2) Front-End Commission	EUR 120,000	100%
Total	**EUR 11,620,000**	

Project Cost Estimates and Financing Plan

Project Costs & Financing Plan (EURm)	EBRD Loan	EBRD Grant	EU/WBIF Grant	Gov. of Albania	TOTAL
Electrification works (incl. contingency, excl. VAT)	11.62	0	11.62	0	**23.24**
Project preparation *	0	0	0.62	0	**0.62**
Implementation support and supervision	0	0	1.16	0	**1.16**
Land acquisition	0	0	0	0.1	**0.1**
Total					**25.12**

* This project component has been completed.